

AKT - THEMELIMI

Ne Ballsh, sot me date 18.6.1996 une Isa Zeqiri, i biri Kadriut dhe Fatmires, i vitlindjes 1963, lindur dhe banues ne Belishove, hartoj kete akt - themelimi:

Me vullnetin tim te lire, duke marre parasysh kerkesat e ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "ZEQIRI", selia e se ciles do te jete ne lagjen "28 nentori" te qytetit Ballsh. Objekt i veprintarise se saj do te jete:

- Prodhim materialesh ndertimi, si gelqere, tulla, inerte, blloqe betoni etj.
 - Tregetim mallrash te ndryshme, brenda dhe jashte vendit (imp.exp), me shumice dhe pakice.
 - Transport mallrash dhe udhetaresh, brenda e jashte vendit.
 - Veprintari ne fushen e ushqimit social, bufe, rosticeri, hoteleri e turizem.
- Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100000 (njehindmije) leke, me kontribut e ortakut te vetem Isa Zeqiri.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Zeqiri" do te kryeje veprintarine e saj tregtare brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe me vendim te organit drejtues, mund te kryeje edhe jashte ketij territori. Po ashtu me vendim te organit drejtues mund te krijoj filiale ne qytete te Shqiperise dhe jashte saj.

Me vendim te ortakut te vetem objekti i veprintarise se shoqerise mund te shtohet ose pakesohet.

Vula e shpk do te jete rrethore me kete permbajtje: S H P K "ZEQIRI" (IMP.EXP.)
BALLSH ALBANIA.

Afati i zhvillimit te veprintarise se saj eshte mbi 10 vjet dhe mbyllja apo likuidimi i mundshem i saj i nenshtrohet legjislacionit perkates shqiptar.

Fitimi qe shoqeria do te nxjerre nga aktiviteti tregtar i saj do te jete ne favor te ortakut te vetem Isa Zeqiri, ne masen 100 perqind te tij.

Organi drejtues i saj do te jete administratori, qe eshte ortaku i vetem Isa Zeqiri.

Marredheniet e punes ne kete shoqeri do te rregullohen sipas legjislacionit shqiptar te punes.

Per funksionimin normal te shoqerise, do te hartohet statuti i saj, ku do te parashikohen hollesisht parimet dhe rregullat ku do te mbeshtetet.

S H P K "ZEQIRI" fiton personalitet juridik me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

Ky akt themelimi dhe statuti, ne nga nje kopje secili depozitohen prane asaj gjykate.

THEMELUESI I S H P K " ZEQIRI "

ISA ZEQIRI

Zeqiri

STATUT

PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ZEQIRI" BALLSH

Une - Isa Kadri Zeqiri, banues ne Belishove te rrethit Mallakaster, nbeshtetur ne ligjin 7638 date 19.11.1992 dhe kontraten e themelimit te dates 18.6.1996, si theme-lues dhe ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Zeqiri" beje kete statut te saj:

DISPOZITA TE PERGJITISHME

Neni 1

Shoqeria tregtare eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me statusin e perso-nit juridik shqiptar.

Neni 2

Ka emertimin "Zeqiri" dhe eshte krijuar me aktin e themelimit date 18.6.1996 te ortakut te vetem Isa Zeqiri, me mjetet e tij financiare.

Neni 3

Qendra dhe selia e saj eshte ne lagjen "28 nentori" te qytetit Ballsh.

Neni 4

Vula e saj eshte rrethore me kete permabajtje: SHPK "ZEQIRI" (IMP. EXP) BALLSH ALBENIA.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shpk "Zeqiri" eshte:

- Prodhim materialesh ndertimi, si gelqere, tulla, inerte, blloqe betoni, etj.
- Tregtim mallrash te ndryshme, brenda e jashte vendit (imp. exp.) me shumice e pakice.
- Transport mallrash dhe udhetarash, brenda e jashte vendit.
- Veprimtari ne fushen e ushqimit social, bufe-restoranti, hotelezi dhe turizem.

Neni 6

Objekti i veprimtarise mund te shtohet apo pakesohet me vendim te ortakut te vetem.

MJETET E SHPK

Neni 7

SHPK "Zeqiri" per fillimin e veprimtarise ka nje kapital themeltar prej 100.000 (njehqindmije) lekesh, prone e ortakut te vetem Isa Zeqiri.

Neni 8

Me mjete te shpk kuptohen edhe ato objekte, sende e te holla qe do te fitchen ne te ardhmen nga ushtrimi i aktivitetit te saj.

Neni 9

Per te siguruar zbatimin e detyrimeve ndaj shtetit apo personave te tjere, juridike e fizike, si dhe per te shtuar veprimtarine e saj shpk krijon nje fond rezerve qe kap 1/20 e fitimit te vitit paraardhes financiar.

Zepiri

ORGANET DREJTUESE TE SHPK

Neni 10

Organi i vetem drejtues, urdherdhenes dhe vendimor i shpk eshte ortakut i vetem, nje-kohesisht administrator i saj Isa Zeqiri.

Neni 11

Ai ka keto kompetenca kryesore: -ndryshimin e emertimit te saj, -caktim te pagave te punonjesve, -emron e shkarkon administratorin ne se ky do te jete jo ortak, -nenshkruan dhe vepron ne emer te shpk ne marrredhenie me te tretet, si dhe kompetenca te tjera te parashikuara ne keto statut, akt-themelimi si dhe akte te tjera te nevonshme juridike.

Neni 12

Kur largohet administratori cakton me shkrim zevendesuesin dhe te drejtat e tij per ate periudhe. Jashte tagrave te dhena me shkrim zevendesuesi nuk mund te dale.

FITIMI DHE NDARJA E TIJ

Neni 13

Fitimi neto ngalet pasi shpk paguan detyrimet ndaj shtetit e personave te trete, shpensimet e tjera te domosdoshme per aktivitetin tregtar. I takon 100% ortakut Isa Zeqiri.

Neni 14

Me vendim te ortakut te vetem nga fitimi i realizuar ndahen stimuj per punonjesit e shpk "Zeqiri". Ortaku i vetem ka nbi vehte rrezikim e humbjes deri 100% te kapitalit themletar dhe reserve.

ORGANIZIMI I PERDITSEM

Neni 15

Per te zhvilluar normalisht aktivitetin e saj shpk ndahet ne njesi te vogla te manovrueshme, sipas caktimit qe i ben ortakut i vetem.

Neni 16

Ne shpk "Zeqiri" mund te aderojne ortakut te rinj ne kushtet e caktuara ne kontraten e bere me rastin e pranimit te tyre.

Neni 17

Per punonjesit e shpk behen kontrata kolektive dhe individuale pune sipas Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise.

Neni 18

Punonjesi i shpk pergjigjet disiplinariisht, materialisht dhe penalisht, sipas rastes per demet e sjella asaj nga veprimet apo mosveprimet e fajshme te tij.

KONEZGJARJA DHE MBYLLJA E SHPK

Neni 19

SHPK "Zeqiri" do te vazhdoj veprimtarine nbi 10 vjet.

Neni 20

Ajo mbyllet ne keto raste: - Kur veprimtaria e saj eshte ne kundersizim me ligjin.

Fepin

-Kur eshte ne falimentin.

Neni 21

Ne se hapen procedurat e falimentimit ato kryhen sipas parashikimit te baze ne ligjin perizates shqiptar per kete operacion.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22

SHPK "Zeqiri" merr personalitet juridik ne rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar qe gjendet prane Gjykatës së rrethit Tiranë.

Neni 23

Kje kopje te ketij statuti, nje kopje te aktit te themelimit dhe kerkese perizatese depositohen prane asaj gjykate.

THEMBELVESI (ORZAKU I VETER) SHPK "ZEQIRI"

ISA ZEQRIRI

Zeqiri

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E RRETHIT FIERR

Nr. 5956 rep.

Fier, ne 18.06. 1996

Y E R R I T I M

Ne Fier, sot ne date 18.06 1996 para meje noterit Minella Milo u paraqit s. Isa Zeqiri, i biri K. dritut dhe F. tairves, i vitlindjes 1963, lindur dhe banues ne Belishove, ne sotesi juridike te plote per te vepruar, njohur ne leternjoftimin personal. Ai deklaroi se kete statut e ka baze vete dhe e konskroi ne presencen time me vullnet te lire, une noteri e vertetoj rregullisht.

NOTERI

MINELLA MILO

